



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.4/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga V.S. nga P., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, R.K., lidhur me lëndën AA.nr.811/2023, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 10.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga V.S., nga P..., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, R.K., lidhur me lëndën AA.nr.811/2023, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën e V.S., nga P.... Në ankesë ka theksuar se aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.nr.811/2023, datë 13.01.2025, i mungon nënshkrimin i gjyqtarit kryesor e që pa dashje mund të i'u ketë rrjedhur një vendim i tillë e i cili është i paligjshëm.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës, me datë 05.02.2025, nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në lëndën AA.nr.811/2023, ka kërkuar deklaram lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja V.S..

Gjyqtari R.K., ka dhënë deklaratë me datën 05.02.2025, ku ka theksuar se me asnjë veprim qoftë si gjyqtar referues apo edhe si koleg në përgjithësi, nuk kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Konfliktet Administrative që rregullojnë çështjet e konfliktit administrativ, dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, konkretisht neni 159, pasi sipas kësaj dispozite nënshkruhet vetëm një kopje e aktgjykimit dhe as në kundërshtim me rregullat e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, përkundrazi konsiderojmë se drejtë dhe plotësisht janë zbatuar dispozitat ligjore me rastin e vendimmarrjes në procedurë sipas ankesës.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit R.K., ka gjetur se:

- ankesa e ankueses V.S., është e **pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi si dhe deklaratës së gjyqtarit, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket mos nënshkrimit të aktgjykimit, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se sipas dispozitës së nenit 159 të LPK “*aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari*:. Pra aktgjykimin burimor e nënshkruan vetëm gjyqtari, nëse ai është gjyqtar i vetëm në një proces gjyqësor. Në rast se kemi të bëjmë me trupin gjykues, atëherë aktgjykimin burimor e nënshkruan kryetari i kolegjit. aktgjykimi burimor ruhet në administratën e gjykatës dhe vetëm kopjet e legalizuara të aktgjykimit u dërgohen palëve. Në rastin konkret gjyqtari R.K. si kryetar i kolegjit duke vepruar sipas dispozitës së lartcekur e ka nënshkruar vetëm aktgjykimin burimor i cili ka mbetur në administratën e gjykatës ndërsa palës i është dorëzuar vetëm kopja e legalizuar e aktgjykimit (e panënshkruar).

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me vendosjen e çështjes së parashtrueses të ankesës, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtari R.K. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës.

Ndërkaq, për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
ADGJA.nr.4/2025, me datë 10.02.2025

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj

Vendimi t'i dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarit R.K.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,